

Gjykata Komunale e Gllgovcit, si gjykatë civile e shkallës së parë me gjyqtaren e EULEX-it Johanna Schokkenbroek, në kontestin në mes të paditësit Murtez Xhekaj nga Gllgovci, i përfaqësuar nga avokati Feriz Gervalla dhe të paditurës Komuna e Gllgovcit, e përfaqësuar nga Avokati Publik i Komunës, Hakif Hasi në rastin për kompenzimin e dëmeve nxjerr këtë:

Aktgjykim

1. Kërkesëpadia e paditësit Murtez Xhekaj nga Gllgovci, për kompenzimin e dyqanit të rrënuar, **APROVOHET PJESËRISHT** dhe e paditura, Komuna e Gllgovcit është e obliguar që t'i kompenzojë dëmet materiale që iu shkaktuan paditësit gjatë rrënimit të dyqanit të tij më 1 dhe 2 mars 2005 (dyqani në vendin e quajtur "Ashanajka" në Gllgovc, numri kadastral 763, lokacioni numër 51, me sipërfaqe 44 m², këtej e tutje i referuar si- dyqani) në një shumë prej 6.600 €, së bashku me kamatën, e cila aplikohet sipas depoziteve bankare për kursime për një periudhë mbi një vit, duke e llogaritur nga data 15 prill 2005, kur ishte ngritur padia e deri në pagesën e fundit.
2. Kërkesëpadia e paditësit për kompenzimin e inventarit të shkatërruar në dyqan **APROVOHET PJESËRISHT** dhe e paditura obligohet që t'i kompenzojë dëmet materiale të shkaktuara në inventarin e paditësit gjatë rrënimit të dyqanit të cilin e shfrytëzonte paditësi më 1 dhe 2 mars 2005 në një shumë prej 1500 €, së bashku me kamatën, e cila aplikohet sipas depoziteve bankare për kursime për një periudhë mbi një vit, duke e llogaritur nga data 15 prill 2005, kur ishte ngritur padia e deri në pagesën e fundit.
3. Kërkesëpadia e paditësit për kompenzim për fitimin e humbur **REFUZOHET** si e pabazuar.
4. Kërkesëpadia e paditësit për kompenzimin e dëmeve jomateriale **APROVOHET PJESËRISHT** dhe e paditura obligohet që t'i kompenzojë dëmet jomateriale që iu shkaktuan paditësit në një shumë prej 250 €. Kërkesa për kamatë **REFUZOHET**.
5. Kërkesëpadia për caktimin e një ngastre të ngjashme për lokal afarist **REFUZOHET** si e pabazuar.

E paditura, Komuna e Gllgovcit urdhërohet që t'ia paguajë paditësit Murtez Xhekaj shumat prej pikës 1, 2 dhe 4 të përmendura më lart, shumën prej 1004 € për mbulimin e shpenzimeve procedurale, si dhe shumën prej 50 € si kompenzim për taksën e paguar gjyqësore brenda 15 ditësh pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Arsyetim:

1. Rrethanat e përgjithshme

Në vitin 1992 Komuna e Glllogovcit ua ofroi individëve mundësinë që të marrin ngastra të tokës për ndërtimin e lokaleve afariste në rrugën kryesore të Glllogovcit. Përafërsisht 60 ngastra iu ishin ndarë individëve në vitet që pasojnë. Disa ngastra ishin lëshuar për shfrytëzim të përhershëm. Ngastra të tjera ishin lëshuar për shfrytëzim të përkohshëm. Ngastrat ishin lëshuar me detyrimin që të ndërtoheshin lokale afariste. Kërkohej leja paraprake e Komunës së Glllogovcit për ndërtim. Lokalet ishin ndërtuar në shumicën e ngastrave të lëshuara dhe iu ishin dhënë lejet e punës pas inspektimit të ndërtimit nga Komuna.

Pas luftës (në shtator 1999) Komuna e Glllogovcit vendosi që t'i lirojë ngastrat dhe i urdhëroi të gjithë pronarët individualë të lokaleve që t'i rrënojnë lokalet e tyre dhe ta lirojnë ngastrën.

Procedurat administrative lidhur me këtë vendim të Komunës së Glllogovcit zgjatën deri në vitin 2005, kur Gjykata Supreme në një kontest administrativ më 21 mars 2005 vendosi t'i shfuqizojë vendimet administrative dhe ta kthejë çështjen në procedurë administrative.

Sidoqoftë, para se të bëhej vendimi i Gjykatës Supreme, Komuna më 15 janar 2005 lëshoi një vendim për lirim të ngastrave.

Më 1 dhe 2 mars 2005 Komuna e of Glllogovcit i rrënoi të gjitha lokalet e përfshira në çështje dhe i liroi të gjitha ngastrat.

Vendimet e mëparshme të Komunës së Glllogovcit për rrënimin e këtyre lokaleve ishin suspenduar nga Administratori Komunal i UNMIK-ut (1999) si dhe nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (7 maj 2001) apo ishin ndërprerë për shkak të një kërkesë të Ombudspersonit në Kosovë.

Procedurat administrative lidhur me urdhërat e Komunës së Glllogovcit për heqjen e lokaleve nuk u vazhduan pas rrënimit në mars të vitit 2005. Në atë kohë, pasi që tanimë lokalet ishin rrënuar, nuk ekzistonte gjithashtu objekt për ndonjë procedurë administrative.

Pas rrënimit në mars të vitit 2005 shumë pronarë të lokaleve të rrënuara paraqitën ankesë para Gjykatës Komonale të Glllogovcit kundër Komunës së Glllogovcit për kompensim.

Pasuan procedurat ligjore (ankesat dhe rigjykimet) lidhur me paditë dhe ato zgjatën për shumë vite.

Sipas kërkesës së 19 paditësve / pronarëve të dyqaneve EULEX-i vendosi që t'i merr këto 19 raste (padi për kompensim) me anë të vendimit të datës 8 dhjetor 2009 (17) dhe atë të datës 25 qershor 2010 (2).

Së paku dy pronarë të lokaleve me kontratë për shfrytëzim të përhershëm të ngastrave të tyre kanë marrë kompensim si rezultat i një vendimi të Gjykatës Komonale të Glllogovcit (në shkallë të dytë të konfirmuar nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës).

2. Padia

Murtez Xhekaj kërkoi:

- 1-Kompenzim për lokalin afarist të rrënuar në një shumë prej 41.800 €, (950 € për metër katror, në bazë të sipërfaqes së përgjithshme të dyqanit, 22 m2 ku përfshihet edhe hapësira nën kulm);
- 2 – Kompenzim për inventarin e humbur në një shumë prej 6.400 €;
- 3 – Kompenzim për fitimin e humbur në një shumë prej 600 € në muaj prej 1 marsit 2005;
- 4- Kompenzim për vuajtje morale/ dëme jomateriale në një shumë prej 7.000 €;
- 5- Caktimi nga ana e të paditurit i një ngastre të ngjashme për lokal afarist;
- 6 – Kamatën e shumave të kërkuara nën 1, 2, 3 dhe 4 të llogaritura në kamatën e depoziteve të kursimeve në bankat e Kosovës.

Paditësi e bazon padinë e tij në faktin se Komuna e Gllogovcit e ka shkelur Ligjin mbi Detyrimet (neni 154) me rrënimin e pronës së tij. Paditësi kërkon kompenzimin për shpenzime procedurale në një shumë prej 1004, €.

Komuna e Gllogovcit e mban qëndrimin se ajo kishte plotësisht të drejtë që ta lironte ngastrën (duke e përfshirë edhe rrënimin e dyqanit) dhe se nuk e kishte shkelur asnjë ligj, pasi që paditësi e kishte zënë ngastrën në mënyrë ilegale. Komuna e Gllogovcit dhe paditësi asnjëherë nuk kishin lidhur kontratë për shfrytëzimin e ngastrës. Rrjedhimisht nuk ekzistonte kurrëfarë baze ligjore që paditësi ta shfrytëzonte ngastrën. E paditura kërkoi kompenzimin për shpenzime procedurale në një shumë prej 611 €.

3. Historia procedurale

Padia ishte ngritur para Gjykatës Komunale të Gllogovcit më 15 prill 2005. Gjykata Komunale e Gllogovcit vendosi më 13 janar 2006 dhe e refuzoi padinë (C.nr. 73/2005). Më 13 shkurt 2006, paditësi parashtrroi ankesë ndaj këtij vendimi para Gjykatës së Qarkut të Prishtinës. Gjykata e Qarkut të Prishtinës vendosi më 25 mars 2008 dhe e prishi vendimin e Gjykatës Komunale të Gllogovcit dhe e ktheu rastin për rigjykim (Ac.nr. 169/2006). Rasti ishte regjistruar në Gjykatën Komunale të Gllogovcit me këtë numër të regjistrimit C.nr. 117/08.

C.Nr 117/08

Më 17 shtator 2008, Gjykata Komunale e Gllgovcit e ndërpreu procedurën me qëllim që të informojë Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, ashtu siç kërkohet me nenet 67 dhe 68 të Ligjit mbi Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Më 25 qershor 2009, paditësi kërkoi nga EULEX-i që ta mirrte rastin.

Më 8 dhjetor 2009, EULEX-i e mori përsipër rastin për rigjykim. Në rigjykim, u mbajtën seanca përgatitore dhe seanca kryesore, ashtu siç përshkruhet në procesverbalin e këtyre shqyrtimeve gjyqësore.

4. Faktet

Gjykata i referohet provave të administruara ashtu siç janë regjistruar në procesverbalin e shqyrtimeve gjyqësore.

Faktet e mëposhtme lidhur më këtë lëndë janë vërtetuar apo sidoqoftë janë të pakontestuar:

Në vitin 1997 Komuna e Gllgovcit ia dha Daut Behramit një ngastër të tokës për shfrytëzim të përkohshëm në vendin e quajtur Ashanajka, parcela kadastrale nr. 763, nr. 51 në Komunën e Gllgovcit me një sipërfaqe prej 22m².

Komuna e Gllgovcit kishte urdhëruar se e drejta për shfrytëzimin e ngastrës ishte individuale dhe ajo nuk mund t'iu bartej palës së tretë apo t'iu dorëzohej palës së tretë.

Gjykata iu referohet provave të administruara të paraqitura nga palët:

- Vendimet e Komunës së Gllgovcit (Departamenti per Planifikim Urban, Banim, Infrastrukturë Komunale dhe Pronë) të datës 23 maj 1997;
- Vendimi i Komunës së Gllgovcit i datës 6 tetor 1997 për dhënien e lejes për ndërtimin e lokalit afarist Daut Behramit;

Daut Behrami lidhi një kontratë me paditësin më 30 korrik 1997. Kjo kontratë ka të bëjë me shitjen e ngastrës (pa lokal të ndërtuar në të). Paditësi nuk ofroi asnjë dokument lidhur me regjistrimin e ndryshimit të pronësisë (neni 36 i Ligji për pronësinë dhe të drejtat sendore).

Gjykata i referohet kontratës së datës 30 korrik 1997 të parashtruar nga palët dhe të administruar si provë.

Paditësi e kishte ndërtuar lokalin afarsit (një dyqan dykatësh) dhe e kishte shfrytëzuar atë për qëllime ekonomike gjatë disa viteve.

C.Nr 117/08

Komuna e Gllgovcit mori një vendim më 28 shkurt 2005, me anë të së cilit e urdhëronte Daut Behramin që ta lironte ngastrën.

Daut Behrami nuk paraqiti ankesë ndaj këtyre vendimeve. Padiësi filloi procedurën (si shumë pronarë të tjerë) për pengim posedimi. Me anë të vendimit të datës 18 mars 2005 (C. nr 36/2004) Gjykata Komunale e aprovoi këtë padi.

Më 1 dhe 2 mars 2005 Komuna e Gllgovcit i rrënoi të gjitha lokalet e përfshira dhe i liroi të gjitha ngastrat. Ky rrënim u bë pa një njoftim paraprak për padiësin (as për Daut Behramin dhe as për pronarët e tjerë të dyqaneve).

Së paku dy pronarë të lokaleve me kontratë për shfrytëzim të përhershëm të ngastrave të tyre kanë marrë kompensim si rezultat i një vendimi të Gjykatës Komunale të Gllgovcit të datës 16 mars 2007 (C.nr 78/05) dhe 21 Shtator 2007 (C.nr 95/05). Komuna e Gllgovcit paraqiti ankesë ndaj të dyja vendimeve. Gjykata e Qarkut të Prishtinës i konfirmoi këto vendime me anë të vendimeve të datës 30 prill 2008 (AC.nr 445/2007) dhe 15 qershor 2009 (AC.937/2007). Në rastin e parë të theksuar më lart pronari i dyqanit mori një kompensim prej 282 € për m2 dhe pronari tjetër i dyqanit mori 540,82 € për m2.

5. Çështjet procedurale të ngritura nga palët

Parashtresat:

A) Moskompetenca e gjykatës

Në një parashtresë Komuna e Gllgovcit e kundërshtoi kompetencën e Gjykatës dhe kërkoi nga Gjykata që ta hedhë poshtë padinë në bazë të moskompetencës së Gjykatës. Sipas Komunës së Gllgovcit, autoriteti kompetent për kontestet administrative është Gjykata Supreme.

Gjykata është e mendimit se ky është një kontest rreth përgjegjësisë për dëmet. Këto dëme janë rezultat i një veprimi të Komunës së Gllgovcit që ka ndodhur në Gllgovc.

Në bazë të nenit 47 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, gjykata kompetente është Gjykata në territorin e së cilës ka ndodhur dëmi.

Gjykata e hodhi poshtë kundërshtimin e Komunës së Gllgovcit si të pathemeltë. Gjykata iu referohet një vendimi të ngjashëm të parashtruar nga Komuna e Gllgovit në një fazë të mëhershme të këtij kontesti.

B) Moskompetenca e EULEX-it

Në një parashtresë Komuna e Gllgovcit e kundërshtoi kompetencën e EULEX-it, pasi që ky kontest nuk ka të bëjë me pronën.

Kjo Gjykatë (kjo gjyqtare e EULEX-it) është e mendimit se ky kontest është çështje civile që ka të bëjë me pronën, ashtu siç shprehet në nenin 5.1 c. të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

C) Kundërshtimi lidhur me Ligjin mbi Menagjimin e Financave dhe Përgjegjësitë

Në një parashtresë tjetër Komuna e Gllgovcit e kundërshtoi obligimin e Gjykatës për të informuar Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave lidhur me procedurën në vazhdim e sipër në pajtim me Ligjin mbi Menagjimin e Financave dhe Përgjegjësitë dhe ndërprejen e procedurës për një periudhë prej 6 muajsh, ashtu siç kërkohet me këtë Ligj. Me këtë rast kjo gjykatë vëren se plotësisht është zbatuar dispozita e Ligjit mbi Menagjimin e Financave dhe Përgjegjësitë nga ana e Gjykatës. Gjykata e ka informuar Ministrinë më 5 dhjetor 2008 dhe e ka ndërprerë procedurën, ashtu siç kërkohet me Ligj. Prandaj, gjykata e konsideron këtë kundërshtim të palës së paditur si të pathemeltë.

D) Kundërshtimi lidhur me Nenin 394 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore

Në një parashtresë tjetër Komuna e Gllgovcit bëri një vërejtje lidhur me rregullsinë e procedurave, duke pretenduar që është dashur që Komunës së Gllgovcit t'iu ishte dhënë mundësia që të parashtrojë një përgjigje me shkrim në padi, në pajtim me nenin 394 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK). Gjykata nuk ka kërkuar nga Komuna e Gllgovcit që të paraqesë përgjigje në padi, për shkak të faktit se neni 394 i LPK-s kërkon nga Gjykata që të kërkojë nga pala e paditur përgjigje në padi, "brenda 15 ditësh pasi që gjykata ta ketë pranuar padinë". Në rastin konkret, është e qartë se kjo nuk ishte e realizueshme, për shkak të faktit se padia ishte dorëzuar në Gjykatë në vitin 2005, kur kjo dispozitë procedurale që kërkonte përgjigje në padi nuk ishte në fuqi. Përveç kësaj, pasi që rasti konkret ishte rigjykim dhe palët tanimë i kishin dhënë qëndrimet e tyre në procedurat e mëhershme dhe nga këto qëndrime ishte e pamundur që të veprohej në pajtim me nenet 398 apo 399 të LPK-s, Gjykata nuk pa ndonjë përfitim substancial që të kërkonte përgjigje në padi nga pala e paditur 5 vite pas dorëzimit të padisë dhe pas shqyrtimeve në dy instanca. Prandaj, kjo vërejtje e palës së paditur nuk është marrë parasysh.

E) Procedurat e AKP-s

Në një parashtresë tjetër Komuna e Gllgovcit bëri një vërejtje lidhur me kompetencat e Gjykatës për ta trajtuar këtë çështje. Kjo vërejtje ishte e bazuar në faktin se paditësi tanimë e kishte paraqitur një kërkesë para Agjensisë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkonte kthimin e pronës. Gjykata e hodhi poshtë kundërshtimin e Komunës së Gllgovcit, duke u bazuar në faktin se Gjykata ka kompetenca të pavarura për të vendosur lidhur me paditë për kompenzim të dëmeve dhe procedurat para kësaj gjykate kanë filluar përpara se të fillonin procedurat para AKP-s. Nuk ekziston dispozitë ligjore, e cila do të shfuqizonte kompetencat e Gjykatës së rregullt, duke u bazuar në faktin e thjeshtë se një padi tjetër ishte ngritur para një institucioni tjetër. Përveç kësaj, nuk ka arsye ligjore, çfarëdo qoftë ajo, që ta ndalë procedurën para kësaj gjykate për kompenzimin e dëmeve, duke pritur vendimin e AKP-s, pasi që vendimi i AKP-s nuk e ka rëndësinë e çështjes paraprake në këtë rast. Prandaj, vërejtja e Komunës së Gllgovcit nuk është marrë parasysh.

F) Kundërshtimi lidhur me mungesën e legjitimitetit të paditësit

Pala e paditur pati vërejtje lidhur me legjitimitetin aktiv të paditësit, duke theksuar se paditësi nuk është pronar i pronës dhe se prona nuk iu ishte dhënë atij në shfrytëzim, dhe prandaj paditësi nuk ka legjitimitet aktiv për të qenë palë në këtë lëndë. Sidoqoftë, objekt i shqyrtimit nuk është raporti në mes të palëve dhe as të drejtat pronësore të cilësdo palë, por vetëm lidhur me detyrimet që kanë të bëjnë lidhur me kompenzimin e dëmeve që iu shkaktuan dyqanit, i cili pa asnjë dyshim ishte nën posedim të paditësit. Gjithashtu, është e pakontestueshme se paditësi ka paguar për shfrytëzimin e dyqanit, gjë që në mënyrë plotësuese e legjitimon paditësin si palë me interes juridik, pra si palë me legjitimitet aktiv, ashtu siç kërkohet me nenin 2.4 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

6. Vlerësimet ligjore sipas fakteve

Kërkesa 1 dhe 2

Kjo padi ka të bëjë lidhur me kompenzimin e dyqanit të dëmtuar (shkatërruar) dhe inventarin e tij.

Është e pakontestueshme se paditësi e ndërtoi lokalin (apo sidoqoftë e përfundoi atë). Është e pakontestueshme se ai ishte pronar i inventarit të dyqanit. E njëjta vlen edhe për materialin, me të cilin ishte ndërtuar lokali. Në të dyja kërkesat (1 dhe 2) janë të përfshira çështje të pronës. Lidhur me (mbrojtjen e) të drejtave të pronës Gjykata i referohet legjislacionit të mëposhtëm:

Në atë kohë (1 dhe 2 mars 2005) ishte në fuqi Rregullorja mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut 2000/ 45).

Kjo rregullore përmban një kapitull " Ekzekutimi i Çështjeve Komunale"(kapitulli 5 Neni 33).

Ky kapitull përmban këtë dispozitë të cituar:

"Parimet e Ligjshmërisë

Ligji dhe drejtësia e obligojnë administratën e komunës që të zbatojë në veçanti të drejtat dhe liritë e njeriut sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut."

Protokolli nr. 1 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore thotë, siç vijon:

Neni 1

Mbrojtja e pronës

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.

Gjatë ushtrimit të këtij pushteti që ka për qëllim interesin e përgjithshëm të cituar më lart, shteti apo çfarëdo organi administrativ, duke qenë pjesë e shtetit (siç është në këtë rast Komuna e Gllgovcit), është i obliguar që t'i bindet ligjit dhe drejtësisë. (neni 33 i Rregullores mbi Vetqeverisjen e Komunave në Kosovë/ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/ 45).

Komuna e Gllgovcit ishte e autorizuar që të merrte masa në mënyrë që ta pastronte ngastrën e tokës (dhe ta përfundonte zënien ilegale) të shfrytëzuar nga paditësi. Sidoqoftë, me ushtrimin e kësaj të drejte Komuna e Gllgovcit është dashur që t'i merrte parasysh edhe interesat (investimet dhe gjërat) e paditësit.

Gjykata konkludon se Komuna e Gllgovcit gjatë ushtrimit të pushtetit të saj fare nuk i ka marrë parasysh interesat e paditësit.

Së pari Komuna e Gllgovcit nuk e shpalli një afat para të cilit duhej të liroheshin ngastrat dhe nuk e shpalli datën se kur vet Komuna e Gllgovcit do t'a lironte ngastrën (shkatërronte lokalit). Konsiderohet nga Gjykata se në këtë rast të veçantë shfrytëzimi ilegal i ngastrës zgjati gati 8 vite (!!) dhe nuk ka pasur urgjencë që të ekzekutohet vendimi për lirim të ngastrës para një date të caktuar (sidoqoftë Komuna e Gllgovcit nuk ka zbuluar ndonjë rrethanë të kësaj natyre dhe gjykata nuk ka mundur të konkludojë ndonjë prej rrethanave të tilla nga dokumentet e parashtruara).

Parimet e përgjithshme të drejtësisë nënkuptojnë gjithashtu që organi administrativ, gjatë ushtrimit të pushtetit për lirim të ngastrës duhet të bëjë përpjekje për zvogëlimin e dëmit të mundshëm ndaj palës së tretë (në këtë rast ndaj paditësit si investitor). Në këtë rast të veçantë Komuna e Gllgovcit është dashur që ta njoftojë paditësin me kohë lidhur me afatin se kur duhej të lirohej ngastra dhe është dashur që ta paralajmërojë atë se Komuna e Gllgovcit do t'i lirojë vet ngastrat, nëse ata vet nuk i lirojnë ato (me shkatërrimin e të gjitha lokaleve të mbetura).

Gjatë senacës kryesore saktësisht u kuptua se Komuna e Gllgovcit nuk ka shpallur një (ndonjë) afat kohor para se të ndodhte rrënimi i dyqaneve më 1 dhe 2 mars 2005. Është e pakontestueshme se rrënimi më 1 dhe 2 mars 2005 ishte i papritur për pronarët e dyqaneve (duke e përfshirë këtu edhe paditësin). Nga dokumentet e parashtruara nga palët konstatohet se Komuna e Gllgovcit nuk ka dërguar ndonjë njoftim (me anë të konkluzioneve, letrave, vendimeve, etj.) pas vitit 2002. Gjykata konstatoi nga raporti i parashtruar nga Ombudspersoni se disa prej pronarëve të dyqaneve ishin të njoftuar lidhur me qëllimin e Komunës së Gllgovcit për lirim (domethënë shkatërrimin) në të ardhmen e afërt. Sidoqoftë, Gjykata konstaton se Komuna e Gllgovcit nuk e ka informuar paditësin në kohë dhe mënyrë të duhur lidhur me ditën që ishte e caktuar për rrënim. Me rezultatin se paditësit iu ishte mohuar mundësia për largimin e gjërave të tij.

Prandaj, shkatërrimi i kryer më 1 dhe 2 mars 2005 nga ana e Komunës së Gllgovcit është një shkelje e nenit 16 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve në lidhje me paditësin. Në bazë të nenit 154, 155 dhe 156 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Komuna e Gllgovcit është e obliguar që t'ia kompenzojë paditësit investimin e humbur (inventarin dhe materialin ndërtimor).

Dëmi dhe kompenzimi:

Rrënimi ndodhi më 1 dhe 2 mars 2005. Do të thotë më shumë se para gjashtë vitesh. Nuk ka mbetur asgjë nga dyqanet e mëparshme. Tani është e pamundur që të vërtetohet shuma e saktë e dëmit të shkaktuar me rrënimin. E njëjta vlen edhe për vlerën e inventarit. Kështu që eksperti nuk do të mund të ndihmonte në vërtetimin e dëmit. Humbja e provave lidhur me dëmin është një rezultat i drejtpërdrejtë nga rrënimi i përgjithshëm i papritur i dyqaneve. Këto rrethana janë tërësisht në rrezik dhe në shpenzime të Komunës së Glllogovcit. Lartësia e dëmit është e bazuar në parimet e përgjithshme të drejtësisë dhe përgjegjshmërisë. Shuma e kompenzimit do të bazohet në m² kati përdhesë (200 €) dhe m² për nënkulm (100 €). Gjykata aprovon padinë për dyqanin e shkatërruar deri në shumën prej 6.600 €.

Për këtë, gjykata ka llogaritur shpenzimet e përafërta lidhur me ndërtimin në kohën kur u bë ndërtimi dhe jo vlerën komerciale të dyqanit, sepse shfrytëzuesi nuk ka pasur të drejtë që ta shesë lokalin. Kompenzimi për inventarin e humbur nuk është specifikuar nga ana e paditësit, edhe pse e kërkuar saktësisht nga Gjykata (aktvendimi i datës 27 gusht 2010). Pasi që Komuna e Glllogovcit nuk e ka kontestuar se inventari ishte lënë në dyqan, Gjykata do ta pranojë se inventari është humbur apo shkatërruar si rezultat i veprimit të shkatërrimit nga ana e Komunës, prej të cilit paditësit iu shkaktuan dëme materiale. Gjykata do ta aprovojë padinë për inventarin e humbur derin në shumën prej 1.500.€. Pasi që nuk kishte ndonjë specifikacion lidhur me vlerën reale të inventarit, kjo ishte caktuar si një shumë e përafërt e një inventari të arsyeshëm i një dyqani të asaj madhësie.

Kërkesa 3 (kompenzimi për fitimin e humbur)

Komuna e Glllogovcit dhe paditësi asnjëherë nuk kanë lidhur ndonjë marrëdhënie në të kaluarën lidhur me ngastrën e tokës për të cilën bëhet fjalë dhe lidhur me të drejtën për të ndërtuar një dyqan (në ngastër). Rrjedhimisht, nuk ekzistonte kurrëfarë baze ligjore që paditësi ta shfrytëzonte ngastrën. Rrjedhimisht Komuna e Glllogovcit ishte e autorizuar që të merrte masa që ta bënte paditësin që ta lironte ngastrën. Prandaj, kjo Gjykatë e refuzoi këtë kërkesë si të pabazuar.

Kërkesa 4 (kompenzimi për vuajtjet shpirtërore/ dëmet jomateriale)

Është e qartë se kjo ngjarje i shkakton paditësit vuajtje shpirtërore/ dëm jomaterial. Për shumicën e pronarëve të dyqaneve kjo do të thotë humbje e burimit të të hyrave të tyre për jetesë. Kjo vlen edhe për paditësin si shfrytëzues i dyqanit pronar i së cilës ishte Fadil Dervishi. Nga natyra e saj ky lloj dëmi nuk mund të kompenzohet me anë të parave dhe dëmi as nuk mund të caktohet saktësisht. Prandaj, gjykata e aprovon një kompenzim simbolik në një shumë prej 250 €. Nuk ekziston bazë ligjore që të aprovohet kamata e kërkuar pasi që shuma e kompenzimit është llogaritur nga dita e sotme.

Kërkesa 5 (caktimi i një ngastre tjetër të ngjashme për lokal afarist)

Kjo kërkesë refuzohet si e pabazuar, pasi që gjykata në të kaluarën asnjëherë nuk kishte lidhur ndonjë marrëdhënie me paditësin lidhur me ngastrën, për të cilën bëhet fjalë.

7 Shpenzimet procedurale

Edhe pse padia ishte aprovuar vetëm pjesërisht, gjykata ka vendosur në pajtim me Nenin 452. 3 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore që pala e paditur do t'i bartë të gjitha shpenzimet procedurale. Kjo ishte vendosur për shkak të faktit se veprimet e palës së paditur sollën deri të kontesti. Ky kontest kishte mundur të shmagej sikur e paditura të kishte treguar vullnet për arritjen e një marrëveshjeje me paditësit për kompenzimin e dëmeve. Pozita e të paditurës si autoritet publik duhet të mirret parasysh si një obligim shtesë për pajtim me qytetarët dhe t'i kushtojë vëmendje të drejtave të tyre pronësore të ligjshme. Gjkata nuk ka vërejtur ndonjë lloj të një vullenti të tillë nga ana e të paditurës. Prandaj, gjykata vendosi që e paditura t'ia paguajë paditësit tërë shumën e shpenzimeve procedurale.

**Gjkata Komunale e Glogovcit,
C.Nr 117/08, data 27 shtator 2011**

**Gjyqtarja e EULEX-it
Johanna Schokkenbroek**

8 Këshilla juridike

Palët mund të paraqesin ankesë ndaj këtij aktgjykimi drejtuar Gjykatës së Qarkut të Prishtinës përmes kësaj gjykate, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi.

E përpiluar në anglisht si gjuhë e autorizuar.